



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 27.02.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“GODINA E RE E STACIONIT TË PMNZ-SË DHE AMBIENTEVE NDIHMËSE TË SAJ  
DHE PRISHJA E GODINËS EKZISTUESE”, ME VENDNDODHJE NË AEROPORTIN  
NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS “NËNË TEREZA” (TIA)

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të “Tirana International Airport” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godina e re e stacionit të PMNZ-së dhe ambienteve ndihmëse të saj dhe prishja e godinës ekzistuese”, me vendndodhje në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza” (TIA), me subjekt zhvillues “Tirana International Airport” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Krujë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
EDH RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDA TOTA

